

Paraqitja e Raportit Vjetor 2023
Seanca Plenare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë
4 korrik 2024

Të nderuar,

Viti 2023 për Zyrën e Komisionerit shënoi një tjetër hap të rëndësishëm në konsolidimin e kuadrit ligjor në fushën e të drejtës për informim, ndërsa presim përmbylljen e procesit të modernizimit tërësor të tij në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Fokusi ynë mbetet inkurajimi për marrjen e masave proaktive, zbatimin e parimeve për mbrojtjen e të dhënave personale në integrimin e teknologjisë, si dhe rritjen e llogaridhënies për pjesëmarrje të qytetarëve në qeverisje.

Mbajtja e edicionit të 15-të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit, në datat 3-5 qershor 2024 në Tiranë, përbën shprehje të besimit, vlerësimit dhe tregues për arritjen e standardeve bashkëkohore të institucionit në këtë fushë.

Nga monitorimi i autoriteteve publike gjatë 2023, ka rezultuar se:

- 305 prej tyre kanë publikuar Programin e Transparencës;
- 332 kanë caktuar koordinatorin, dhe
- 310 kanë funksional Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve.

Për të katërtin vit radhazi, u realizua monitorimi vjetor i të gjitha autoriteteve publike (AP) dhe u hartuan 2 indekset e transparencës:

- Indeksi i Transparencës Proaktive të Institucioneve Qendrore dhe të Varësisë (242 AP).
Krahasuar me vitin parardhës, konstatohet rritje e numrit të AP të përfshira në grupin e parë me performancë të lartë, nga 12% në 38% në raport me totalin.
- Indeksi i Transparencës Proaktive të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (61 NjVV dhe 12 Këshillat e Qarqeve).

Vlerësojnë rritje të numrit të NJVV të përfshira në grupin e parë me transparencë proaktive të lartë, nga 21% gjatë 2022 në 29% për 2023, në raport me totalin, çka shënon dhe përmirësimin më të dukshëm të bërë nga monitorimet paraardhëse.

Zyra e Komisionerit administroi 956 ankesa për vitin 2023, si dhe vijoi me shqyrtimin administrativ të 48 procedurave të mbartura nga viti 2022, **gjithsej 1004 ankesa**.

Komisioneri është shprehur me **45** vendime për **46** ankesa, nga të cilat **41** vendime urdhërimi për dhënie informacioni, **3** vendime rrëzimi, dhe **1** vendim me sanksion administrativ.

Kërkimi i informacionit/dokumentacionit u përqendrua për fondet e buxhetit të shtetit, partneritetet publike-private/koncensionet, prokurimet, mjedisin, trashëgiminë kulturore, planifikimin e territorit, ndihmën ekonomike, vendime të gjyqësorit, të dhëna statistikore mbi veprimtarinë e autoriteteve publike, etj.

Ndër problematikat kryesore të verifikuara nga shqyrtimi i ankesave përmendim:

- drejtuesit e autoriteteve publike nuk kujdesen për publikimin dhe përditësimin e informacionit në Programin e Transparencës.
- Konstatohet rezistencë, si dhe padijeni/mungesë ndërgjegjësimi nga ana e administratës për të publikuar në mënyrë proaktive informacion me karakter publik, duke filluar nga jetëshkrimi i drejtuesve/anëtarëve të kabineteve, legjislacioni i përditësuar, rregulloret, të dhënat e realizimit të buxhetit, listën e kontratave të nënshkruara dhe deri tek informacioni mbi ofrimin e shërbimeve për qytetarët.
- Në tërësi konstatohet mungesë ndërgjegjësimi, shoqëruar në jo pak raste edhe me neglizhencë.

Kjo reflektohet qartë gjatë procesit të shqyrtimit të ankimit administrativ, ku mbi 70% e ankesave (nga rreth 1000 të tilla në vit) zgjidhen dhe merret informacioni me fillimin e procesit të shqyrtimit apo të hetimit administrativ nga Zyra e Komisionerit. Situata e cila prodhon kosto të panevojshme në lidhje me perceptimin publik për transparencën e autoritetit publik dhe në tërësi, për zbatimin e të drejtës për informim. Prodhon kosto gjithashtu dhe administrative/në kohë dhe në burime njerëzore, por kosto më e rëndë është në procesin e integritetit në BE dhe Raportet e Vlerësimit ku transparenca dhe llogaridhënia e administratës publike është një nga kriteret bazë.

- Ende konstatohet ndryshim i shpeshtë i koordinimit, caktimi i tij/i saj në nivel ekzekutiv, apo të ulët drejtues si dhe kufizim aksesit në strukturat e tjera të autoriteteve publike.

Rekomandimi i vazhdueshëm është fuqizimi i koordinimit për të drejtën e informimit, si fytyra e autoritetit publik në raport me qytetarët, nëpërmjet aksesit të drejtëpërdrejtë me titullarin, si dhe për atë sa mund të jetë e mundur krijimi i një pozicioni/strukture të dedikuar për këtë funksion.

- Vazhdon të ketë paqartësi nga ana e autoriteteve publike lidhur me konceptin e konfidencialitetit në kontratat publike, i trajtuar jo në përputhje me parashikimet e nenit 17 të ligjit për të drejtën e informimit.
- Autoritetet publike refuzojnë të vendosin në dispozicion informacionin e kërkuar, duke pretenduar për dëme të cilat mund t'i shkaktohen shtetit shqiptar nga palë të treta (procese që mund të atakohen në gjykatë/arbitrazh), pa referuar bazën ligjore mbi të cilën ngrihet ky pretendim, si dhe pa bërë testin e domosdoshmërisë, proporcionalitetit dhe interesit publik gjatë kufizimit të informacionit.
- Vijnë të këtë raste të keqinterpretimit të së drejtës së autorit të subjekteve të cilët marrin pjesë në një procedurë administrative ku shkohet përtej nga parashikimet e nenit 17 të ligjit për të drejtën e informimit apo legjislacionit specifik që rregullon të drejtën e autorit.
- Shpesh herë delegohen kërkesat për informacion nga njëri autoritetet te tjetri, edhe pse informacioni i kërkuar disponohet nga vetë autoriteti publik i cili e ka deleguar atë.

Ne mbështetemi në parimin e mirëbesimit, duke marrë të mirëqënë përgjigjen e kthyer, mbështetur kjo edhe në parimin e luajalitetit mbi të cilin duhet të funksionojë e gjithë administrata publike dhe veçanërisht raporti autoritetet publik - Komisioner.

- Konstatohet një mos rakordim midis strukturave të brendshme të autoriteteve publike apo edhe për përcjelljen në zyrën e medias të kërkesave të gazetarëve, cilat lidhen me pyetje, intervista, apo prononcime në media të titullarëve.
- Vështirësi në realizimin e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik më e theksuar nga ana e Këshillave Bashkiake, të cilët duhet të koordinohen me administratat e Bashkive dhe të publikohet në Programin e Transparencës në faqen zyrtare.
- Kërkuesit vijojnë të përdorin dispozitat e ligjit përtej objektit dhe qëllimit të tij për çështje/praktika administrative me karakter individual, si: aksesit në të dhënat personale, dokumentacioni lidhur me lejet e ndërtimit, pronësisë, procedurave të rekrutimit, etj.
- Vijojnë ankesat nga avokatët për akses në dokumentacionin e njehësuar, i cili shërben si provë në procese gjyqësore, duke anashkaluar në këtë mënyrë ligjin për avokatinë, apo Kodin e Procedurave Administrative.

Si çdo vit, në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit dhe në portalin *pyetshtetin.al* publikohet lista e ankesave të administruara, në funksion të transparencës për publikun, e cila mund të konsultohet lehtësisht nga qytetarët apo grupet e interesit.

Me hyrjen në fuqi në muajin prill 2023 të ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, ka vijuar procesi për hartimin e akteve nënligjore, si dhe identifikimin e të dhënave të hapura që organet e sektorit publik kanë në dokumentet ekzistues apo që i gjenerojnë rishtazi me qëllim publikimin e tyre sipas standardeve të kërkuara.

Ndërsa në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, gjatë vitit 2023 nuk janë administruar ankesa, por praktika administrative/komunikim shkresor me institucione apo grupe interesi.

Gjatë vitit 2023 u realizua instalimi i Regjistrimit Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit në 27 autoritete të reja, duke e çuar në **222** numrin e tyre. Në këtë mënyrë, kemi realizuar targetin për vitin 2023 të Kontratës së Mbështetjes Buxhetore BE për Mirëqeverisjen.

Përbushja e këtij indikatorit për këtë vit sjell në buxhetin e shtetit vlerën prej 800 000 euro, duke e çuar në total për 4-vjeçarin e kontratës kontributin e Zyrës së Komisionerit në buxhetin e shtetit përmes kësaj mbështetje buxhetore në **3 milionë e 800 mijë euro**.

Për të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale gjatë vitit 2023 u administruan **394** ankesa nga qytetarët, duke konfirmuar gjithnjë e më shumë kuptueshmërinë e subjekteve të të dhënave personale/qytetarëve për rëndësinë e mbrojtjes së kësaj të drejte themelore.

Nga vlerësimi i objektit të ankesave, ndër tipologjitë kryesore përmendim: përhapjen e paligjshme të të dhënave personale; ushtrimin e të drejtës për akses për korrigjim/fshirje të të dhënave personale; marketingun e drejtpërdrejtë në lidhje me komunikimet e pakërkuara, apo ofrimin e shërbimeve nga zyrat noteriale.

U realizuan **47** hetime administrative në kontrollues të ndryshëm, nga të cilat **32** me iniciativën e institucionit—*ex officio* dhe **15** hetime janë zhvilluar për verifikimin e ankesave të qytetarëve.

Pjesë e këtij procesi është edhe zhvillimi i 37 seancave dëgjimore me palët.

Në zbatim të Rezolutës së Kuvendit, u zhvilluan hetime administrative:

- me objektin tematik zbatimi i masave tekniko-organizative për përpunimin e sigurt të të dhënave personale, veçanërisht, për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit (SMSI), në:
 - sektorin financiar jo bankar, 3 inspektive në kontrollues privat, në përfundim të të cilave Komisioneri doli me 1 Relacion dhe 2 Rekomandime;
 - sektorin e administrimit dhe ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme (real estate) 9 inspektive në kontrollues privat, në përfundim të të cilave Komisioneri doli me 4 Rekomandime dhe 2 Vendime.
- Me objektin tematik mbi respektimin e disa detyrimeve ligjore, si: informimi dhe pëlqimi i qytetarëve, njoftimi në Regjistrin Elektronik të Kontrolluesve, masat e sigurisë, etj, si në kontrollues publik ashtu edhe në ata privat.

Në këtë drejtim hetimet administrative u zhvilluan në:

- në sektorin e arsimit, 13 inspektive kryesisht në kontrollues privat, në përfundim të të cilave Komisioneri doli me 2 Relacione, 1 Urdhër për fshirjen e të dhënave personale (fotografi/video të fëmijëve të publikuara në rrjetet sociale), 5 Rekomandime dhe 5 Vendime;
- në sektorin e marketingut të drejtpërdrejtë, 10 inspektive në kontrollues privat, në përfundim të të cilave Komisioneri doli me 5 Relacione, 1 Rekomandim dhe 4 Vendime;
- në sektorin e shërbimit postar, 7 inspektive (4 në kontrollues publik dhe 3 në kontrollues privat), në përfundim të të cilave Komisioneri doli me 2 Rekomandime dhe 2 Vendime;
- organet ligjzbatuese (në proces), ku përfshihet sistemi i prokurorisë - në funksion të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Eurojust; si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Disa nga problematikat kryesore të konstatuara gjatë kësaj veprimtarie janë:

- kontrolluesit nuk disponojnë rregullore specifike për përpunimin, mbledhjen, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale;
- specifikisht, kontrolluesit nuk disponojnë strategji ose plan për SMSI, që përfshin të gjithë komponentët e një sistemi të kompletuar për menaxhimin e sigurisë së informacionit;
- kontrolluesit nuk informojnë qartësisht subjektet e të dhënave mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të tyre (përmes faqes zyrtare, apo formularëve të ndryshëm që aplikojnë, përdorimin e sistemeve të survejimit me kamera (CCTV), etj.), personin që do t'i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë ata, apo afatin e mbajtjes së të dhënave;
- kontrolluesit nuk kanë marrë masat e duhura për të garantuar konfidencialitetin e të dhënave që përpunohen;
- kontrolluesit nuk kanë të parashikuar një afat konkret të ruajtjes së të dhënave personale;
- kontrolluesit nuk respektojnë detyrimin për njoftim dhe/ose përditësim pranë Zyrës së Komisionerit, sa herë që shtohen proceset përpunuese apo kategoritë e të dhënave personale;

- kontrolluesit nuk parashikojnë detyrime në përputhje me normat përkatëse ligjore në rastet e delegimit të proceseve përpunuese të palë të treta (në cilësinë e përpunuesit);
- kontrolluesit nuk i kushtojnë vëmendje domosdoshmërisë së trajnimit të vazhdueshëm të nëpunësve/punonjësve që kanë akses në të dhënat personale dhe mbikëqyrin proceset përpunuese.

Një rëndësi i është kushtuar edhe mbikëqyrjes ligjore për kontrollues që administrojnë databaza të rëndësishme shtetërore me përmbajtje të madhe të të dhënave personale. Ndër problematikat kryesore të konstatuara gjatë hetimeve administrative të realizuara pranë kontrolluesve të sipërcituar:

- aksesimi i databazës AFMIS dhe SMIP nga përdorues administrativ nëpërmjet llogarive personale (qytetar) të krijuara për qëllimin e përfitimit të shërbimeve që ofrohen në portalin unik qeveritar *e-Albania*;

Gjithashtu, në kuadër të verifikimit të zbatimit të masave të lëna më herët në aktet vendimmarrëse të Komisionerit, u zhvilluan 9 hetime administrative në kontrollues privat, ku në përfundim 4 prej tyre i'u vendos sanksion administrativ për mos përmbushje të detyrimeve të lëna.

Në shifra përmbledhëse, për vitin 2023 Komisionerit u shpreh me 1 Urdhër; 21 Rekomandime; 19 Vendime, të cilat korrespondojnë me 64 sanksione administrative.

Rëndësi i është kushtuar konsolidimit të figurës së Nëpunësit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Data Protection Officer-DPO).

Kjo qasje e re është materializuar nëpërmjet krijimit të një rrjeti të posaçëm komunikimi mes Zyrës së Komisionerit dhe DPO. Aspekti teknik i kësaj marrëdhënie është funksionimi i Rregjistrimit të Nëpunësve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili në fund të vitit 2023 përmban të dhënat e 435 DPO.

Në aspektin ndërgjegjësues dhe promovues Zyra e Komisionerit, i ka kushtuar rëndësi edukimit dhe komunikimit proaktiv me qytetarët apo grupet e interesit. Gjatë vitit 2023 janë zhvilluar rreth 30 aktivitete të karakterit informues/trajnues. Një kontribut shumë të vlerësuar në këtë drejtim ka dhënë bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe organizatat e medias.

Në kuadër të menaxhimit të buxhetit, realizimi faktik i buxhetit është në nivelin 98.1%, por nevojat e institucionit vijnë në rritje, për shkak të shtimit të funksioneve dhe të standardeve cilësore që kërkohen për ofrimin e tyre.

Në përfundim, vlerësoj se pak më shume vëmendje për institucionet e pavarura i shërben konsolidimit të shtetit, dhe, në rastin e Zyrës së Komisionerit, garantimit të dy të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të drejtën për informim me mirëqeverisjen, transparencën, llogaridhënien si parakushte të luftës kundër korrupsionit, dhe nga ana tjetër mbrojtjen e të dhënave personale për sigurinë e qytetareve dhe deri në sigurinë kombëtare të vendit tonë.

Ju faleminderit për vëmendjen.